

## **Ndërhyrja e Herëshme**

### **Udhëzues i Shkurtër për Tranzicionin në Kopësht**

Kjo është një referencë e shkurtër për prindërit e fëmijëve me paaftësi, që mund të shkojnë në klasat e kopështit (datëlindja është në, ose përpara datës 1 Shtator).

#### **Hapi i Parë**

**Pyesni** ofruesin e shërbimit të fëmijës ose Koordinatorin e “Elwyn Service Coordinator” rreth regjistrimit në klasat e Kopështit. Ofruesi i shërbimit të fëmijës, ose Koordinatori i “Elwyn Service Coordinator” do t’ju japë një formular **Intent to Register**

“Intent to Register” është një dokument, që njofton Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, ose shkollën “Charter” se ju:

- **Keni qëllim** të regjistroni fëmijën tuaj në programin e Kopështit
- **Nuk keni qëllim** të regjistroni fëmijën tuaj në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, ose shkollën “Charter”
- **Keni qëllim të qëndroni edhe një vit tjetër** në shërbimet e “Elwyn”

Në rast se ju firmosni “Intent to Register” dhe **“intend to enroll”** për fëmijën tuaj në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, ose në Shkollën Charter, nga ju do të kërkohet një ballafaqim.

#### **Hapi i Dytë**

**Ndiqni** ballafaqimin e caktuar prej ofruesit të shërbimit të fëmijës. Në këtë ballafaqim ju do të takoheni me një përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ose të shkollës Charter. Në këtë ballafaqim, përfaqësuesit do të diskutojnë:

- IEP e Fëmijës tuaj
- Lejen për Rivlerësim
- Regjistrimin për në klasën e Kopështit

Ju do të merrni informacion se **kur** dhe **ku** të regjistroheni për në kopësht.

#### **Hapi i Tretë**

**Regjistroni** fëmijën tuaj në shkollën e zonës të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ose në shkollën Charter duke filluar nga data **20 Janar**. Kur të shkoni për regjistrimin e fëmijës në shkollën e zonës, **ndiqni** këto hapa:

- **Sillni** dokumentat e mëposhtëm:
  - Çertifikatën e Lindjes së Fëmijës
  - Rekordet e Vaksinimeve të Fëmijës
  - Prova të Adresës
    - Patentën e Shoferit ose ID e PA
    - Faturë (Gazi ose Elektriку)
    - Çeku i Punës
- Bëni me dije personit që do t’i flitni, se ju keni qëllim të regjistroni fëmijën tuaj në klasën e Kopështit dhe se fëmija merr Shërbime të Ndërhyrjes së Herëshme.